



MIE

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË

NR. 1180/1 Rep.
NR. 1180/1 Kol.



**MARRËVESHJE
“PËR**

**ZGJIDHJEN ME KONSENSUS TË KONTRATËS SË KONCESIONIT TË
FORMËS “BOT” (NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM) PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALEVE “GOMSIQE 1”, “GOMSIQE 2”, “GOMSIQE 3”,
“GOMSIQE 3” DHE “GOMSIQE 4” (KONTRATA E KONCESIONIT NR. 2851
REP., NR. 380 KOL., DATË 10.09.2009), E NDRYSHUAR**

Në Tiranë, më datë 16, muaji Prator, viti 2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), para
meje noter Armando Dervishi anëtar i dhomës së Noterisë JUROR me adresë
Samir Pallevi, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, që në vijim do të citohet “MIE” në cilësinë
e Autoritetit Kontraktues, pi rfaqi suar me Autorizimin nr. 13530 Prot, datë 02.11.2018, nga
znj. Etleva Kondi e datëlindjes , madhore dhe me zotësi juridike për të vepruar, për
identitetin e të cili s u sigurova nga Letërnjoftimi ID me nr. personal , nr. Letërnjoftimi**

DHE

**Shoqëria “HEC GOMSIQE” sh.p.k themeluar si person juridik datë 09.10.2009 dhe
regjistruar në QKR datë 13.10.2009 me NIPT K92213011R, përfaqësuar ligjërisht nga
administratori i shoqi risë Z.Rreoland Jegeni, i datëlindjes , madhor dhe me
zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftimi me nr.
personal nr. dhe nr. Letërnjoftimi**

të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Marrëveshje për zgjidhjen me konsensus të Kontratës së Koncesionit të
formës “BOT” për ndërtimin e hidrocentraleve “Gomsiqe 1” & “Gomsiqe 2”, “Gomsiqe
3”, “Gomsiqe 3” dhe “Gomsiqe 4” Nr. 2851 rep., nr. 380 kol., datë 10.09.2009, e
ndryshuar me Kontratën Nr. 8 Rep, Nr.4 Kol., nënshkruar më datë 11.01.2013.

Hyrje

Duke pasur parasysh që:

- Në Kontratën Koncesionare të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (sot MIE) dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Roan Company" sh.p.k., "Shansi Invest" sh.p.k., "Archimed International" sh.p.k., "Sigers" sh.p.k., "Sina - 98" sh.p.k., (Koncesionari) me Nr. 2851 Rep. & Nr. 380 Kol., për ndërtimin e hidrocentraleve "Gomsiqe 1", "Gomsiqe 2", "Gomsiqe 3", "Gomsiqe 3" dhe Gomsiqe 4", në rrjedhin e lumit Gomsiqe, Pukë, e cila ka hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët datë 10 shtator 2009, (në vijim referuar si "Kontrata e Konçesionit") ndryshuar me Kontratën Nr. 8 Rep, Nr.4 Kol., nënshkruar më datë 11.01.2013 "Për ndërtimin e hidrocentraleve Gomsiqe 1 dhe Gomsiqe 2", në pikën 12.5 të nenit 12, "Zgjidhja e Kontratës me Konsensus" cilësohet se "Palët kanë të drejtë të zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm, duke negociuar mënyrën e kompesimit të investimit. Gjithsesi Koncesionari ka të drejtë të kërkojë Sigurimin e Kontratës nëse ekziston".

-Shoqëria koncesionare "HEC GOMSIQE" sh.p.k. themeluar si person juridik datë 09.10.2009 dhe regjistruar në QKR datë 13.10.2009 me NIPT K92213011R, me shkresë nr. 13 prot, datë 26.10.2018 (prot MIE nr.7079/8, datë 26.10.2018) ka paraqitur kërkesën në MIE për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes palëve dhe zgjidhjen e kontratës.

Me shkresën nr. 7079/9 prot, datë 31.10.2018 të MIE u kërkua takim dhe në vijim të takimit të datës 02.11.2018 ora 12⁰⁰, me procesverbalin mbajtur u konkludua;

- Palët vlerësojnë dhe pranojnë se problemet në zbatimin e kushteve dhe afateve të kontratës së koncesionit, kanë ndodhur për shkak të vonesave që i janë krijuar shoqërisë në procedurat e dhënies së lejeve përkatëse nga subjektet shtetërore, argumentuar me dokumentat bashkëlidhur shkresës së protokolluar në MIE me nr.7079/3, datë 17.08.2018

- Referuar nenit 22 "Pika e mosmarrëveshjeve" pika 22.1 "Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë";

- dhe nenit 12, pika 12.5 "Zgjidhja e kontratës me konsensus" të Kontratës së Koncesionit të formës "BOT" për ndërtimin e hidrocentraleve "Gomsiqe 1", "Gomsiqe 2", "Gomsiqe 3", "Gomsiqe 3" dhe Gomsiqe 4", me Nr. 2851 Rep. & Nr. 380 Kol., e ndryshuar palët bien dakort sa më poshtë vijon:

Neni 1

Palët bien dakort me vullnet të mirë dhe mirëkuptim të shterojnë të gjitha mosmarrëveshjet dhe Shoqëria Koncesionare "HEC GOMSIQE" sh.p.k., nisur nga negociatat e zhvilluara deri tani, *heq dorë* nga padia paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë me datë 12 tetor 2018; me Nr. Akti 4780, datë 17.10.2018

“Njoftim” (protokoluar në MIE me nr.1267, datë 23.10.2018) ndaj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas nenit 201/a të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 2

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, Palët bien dakort të zgjidhin me konsensus Kontratën e Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim-Operim-Transferim) të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (sot MIE) dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Roen Company” sh.p.k., “Shansi Invest” sh.p.k., “Archimed International” sh.p.k., “Sigers” sh.p.k., “Sina – 98” sh.p.k., (Koncesionari) me Nr. 2851 Rep. & Nr. 380 Kol., për ndërtimin e hidrocentraleve “Gomsiqe 1”, “Gomsiqe 2”, “Gomsiqe 3”, “Gomsiqe 3” dhe “Gomsiqe 4”, datë 10 shtator 2009, (në vijim referuar si “Kontrata e Koncesionit”) ndryshuar me Kontratën Nr. 8 Rep, Nr.4 Kol., nënshkruar më datë 11.01.2013 “Për ndërtimin e hidrocentraleve Gomsiqe 1 dhe Gomsiqe 2”.

Neni 3

Shoqëria Koncesionare me këtë akt i dorëzon Autoritetit Kontraktor, i cili pranon pa ndonjë kundërshtim, sa vijon:

-të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, ofshin këto tregtare apo teknike;

-çdo të drejtë tjetër të fituar prej saj nëpërmjet Kontratës së Koncesionit.

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Autoriteti Kontraktor heq dorë nga çdo kërkim sipas Çertifikatës së Garancisë së Kontratës nr. 16/0101/030117, shtesa 1, datë 01.11.2011, lëshuar nga Sigal Uniqa Group Austria, dhe kjo çertifikatë nuk do të jetë më e vlefshme për shkak të zgjidhjes me mirëkuptim të Kontratës së Koncesionit. Për këtë qëllim, Autoriteti Kontraktor do të njoftojë me shkrim shoqërinë e sigurimeve Sigal Uniqa Group Austria brenda 5 ditësh nga data e kësaj Marrëveshjeje.

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët deklarojnë se, nuk kanë asnjë kërkesë për detyrime financiare apo detyrime të tjera përkundrejt njëra-tjetrës, si dhe heqin dorë nga çdo pretendim, padi apo kërkim përkundrejt njëra-tjetrës në lidhje me Kontratën e Koncesionit dhe zgjidhjen e saj.

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Autoriteti Kontraktues sipas gjykimit të tij ka të drejtë të riçelë përsëri garën konkurrese për zhvillimin e këtij projekti qoftë dhe në mënyrë pjesore.

Neni 4

Koncesionari merr përsipër të zbatojë të gjitha modalitetet juridike të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, për likuidimin e Shoqërisë Koncesionare “HEC GOMSIQE” sh.p.k., të krijuar në bazë të pikës 8.1, të nenit 8 “Detyrimet e koncesionarit”, të Kontratës Koncesionare, dhe çregjistrimin në QKB, bazuar në kuadrin ligjor mbi bazën e të cilit operon ky institucion.



Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët. Me nënshkrimin e saj pushojnë të gjitha efektet ligjore të Kontratës së Koncesionit të formës "BOT" për ndërtimin e hidrocentraleve "Gomsiqe 1", "Gomsiqe 2", "Gomsiqe 3", "Gomsiqe 3" dhe "Gomsiqe 4", me Nr. 468 Rep. & Nr. 238 Kol., datë 10 shtator 2009, e ndryshuar.

Kjo Marrëveshje u hartua në 4 (katër) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES

SHOQËRIA KONCENSIONARE

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

"HEC GOMSIQE" SH.P.K

Përfaqësuar nga:

Përfaqësuar nga:

Znj. Etleva Kondi

Z. Rreoland Jegeni

DREJTOR

A MINISTRATOR